ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **33600-23-5845-5-2-1**

Sa i përket tenderit për **Instalimi i paneleve djellore për ngrohjen e ujit sanitar në Q. K. Dubrave**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**" EJONA " SH.P.K.**
NUI	**810089913**
Adresa	**Zahaq**
Vendi	**Peja**
Kodi postar	**30000**
Numri Telefonit	**049137987**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Ejona Prelvukaj**
Adresa elektronike	**info@ejona.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**08.12.2023**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Instalimi i paneleve djellore për ngrohjen e ujit sanitar në Q. K. Dubrave

08.06.2023 Njoftimi per kontrat

30.06.2023 Hapja e ofertave

25.08.2023 Vendimi i AK 1

03.11.2023 Vendimi i OSHP-se

04.12.2023 Vendimi i AK 2

11.12.2023 Kerkesa per Rishqyrtim

15.12.2023 Refuzimi i Kerkeses per Rishqyrtim

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Eshte hera e dyte qe kjo lende shkon ne OSHP per shkak te vendimeve te pabaza te AK-se.

AK tenton qe me cdo kusht te anuloje kete aktivitet te prokurimit, se pari duke na eliminuar nga gara pa baze dhe se dyti duke e anuluar tere aktivitetin me arsyetimin se nuk kane buxhet.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

PRETENDIMI 1)

Neni 62
Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Neni 43
Ndërprerja e procedurave të prokurimit

43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:
a. asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;
b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;
c. numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre);
d. nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;
f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
g. asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;
h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;
i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të

parandalohet përmes një ndryshimi;
j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedures ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose
k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

PRETENDIMI 1)

Pasi qe OSHP mori vendim qe te cilesoje ankesen tone si te bazuar, pra qe AK nuk ka pasur te drejte te na eliminoje nga gara sepse ishim te pergjegjshem.
Si duket AK-se nuk i pelqeu vendimi i OSHP-se dhe vendosi qe te anuloje tere aktivitetin me pretendimin se tani me nuk kane buxhet per kete aktivitet.
Per te mbeshtetur kete pretendim AK bashkangjet nje leter e cila daton nga viti 2021, ku shenon se buxheti per kete projekt eshte i parapare ne vitin 2023.
Eshte teresisht normale qe ne vitin 2021 te mos parashihet se AK do te vonoje proceduren me vendime te jashteligjshme, andaj ajo leter nuk mbeshtet asgje.

Sipas LPP dhe Rregullores se Prokurimit publik, perkatesisht ***Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit*** dhe ***Neni 43 Ndërprerja e procedurave të prokurimit*** , egzistojne vetem disa kushte qe nje aktivitet te anulohet, dhe ato kushte nuk jane plotesuar asnjera per kete aktivitet.

Per kete qeshtje ne kemi kerkuar edhe interpretim nga KRPP, ku KRPP na pergjigjet se ne LPP eshte shume e qarte se cilat kushte duhet te plotesohen per anulimin e nje aktiviteti publik, dhe mungesa e buxhetit nuk eshte asnjera prej atyre kushteve.

Bashkangjitur gjeni edhe interpretimin e KRPP lidhur me kete qeshtje.

PERFUNDIM:

Kerkojme nga OSHP, te marre vendim per anulimin e vendimit te AK per shkak te

shkeljeve te LPP.
Kerkojme qe lenda te kthehet ne rivleresim, ku do te shpallemi si OE i pergjegjshem me cmimin me te ulet te ofertuar.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*